



ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË

UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI
FAKULTETI I DREJTËSISË

Nr. 892 Prot , datë 04/04/2024

Nr. 199 Prot , datë 04/04/2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

DHE

FAKULTETIT TË DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI"

4 Prill 2024

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

dhe

Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit “Luigj Gurakuqi” referuar më tutje si “Fakulteti i Drejtësisë”, referuar së bashku si “Palët”,

Duke pasur parasysh fushat e përbashkëta të interesit me synim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe rritjen e transparencës në raport me misionin kompetencat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e ndërsjellë, në funksion të punës së përbashkët, me qëllim forcimin e bashkëpunimit për edukim ligjor dhe komponentëve të tjerë të përbashkët;

Duke marrë për bazë vullnetin e dyanshëm, për të krijuar mundësi dhe ura të reja bashkëpunimi që ndihmojnë të dyja palët të ndërmarrin nisma të përbashkëta;

Duke shprehur besimin e thellë që ky bashkëpunim do të konkretizohet edhe me nisma dhe mekanizma të tjerë të përbashkët në të ardhmen,

Palët nënshkruese të këtij memorandumi janë pajtuar si vijon:

Neni 1

Objekti i Memorandumit

1. Ky Memorandum ka për qëllim zhvillimin e një kuadri bashkëpunimi mes Palëve.
2. Palët pajtohen që të zhvillojnë veprimtari dhe programe të përbashkëta, me qëllim thellimin dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e drejtësisë, që kanë për synim konkretizimin e mandatit të palëve me iniciativa të përbashkëta.

Neni 2

Aktivitetet e bashkëpunimit

1. Palët pajtohen të zhvillojnë aktivitetet e bashkëpunimit si vijon:
 - a. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta në fushën e drejtësisë, përfshirë nisma që kanë karakter akademik, hulumtues dhe të shkëmbimit të përvojave të nevojshme;
 - b. Shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta për ndërtimin e programeve edukuese, që i shërbejnë komunitetit të studentëve;

- c. Mundësinë e praktikës për studentët e Fakultetit të Drejtësisë, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - d. Organizimin e tryezave dhe ligjëratave që kanë në fokus edukimin ligjor dhe profesional;
 - e. Organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta, duke pasur parasysh funksionin e palëve.
2. Angazhimi i studentëve të Fakultetit të Drejtësisë në punë praktike në kuadër të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të bëhet duke pasur parasysh rregulloret e brendshme të institucionit.
 3. Fakulteti i Drejtësisë merr përsipër, që sipas nevojës t'i përgjigjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në aktivitete të përbashkëta dhe të ofrojë ekspertizën e personelit akademik, varësisht nga vlerësimi i përbashkët.

Neni 3

Personat e kontaktit dhe komunikimi mes Palëve

1. Palët caktojnë nga një ose më shumë anëtarë të stafit të tyre si persona kontakti, me përgjegjësi për mbajtjen e të gjithë komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe përgatitjes së nevojshme për zbatimin e këtij Memorandumi.
2. Palët komunikojnë me shkrim sa i përket koordinimit dhe përgatitjeve të nevojshme lidhur me aktivitetet e bashkëpunimit të parashikuara në nenin 2 të këtij Memorandumi, si dhe në përgjithësi lidhur me zbatimin e këtij Memorandumi.
3. Komunikimi mes Palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore ose përmes postës elektronike, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Neni 4

Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky memorandum lidhet për një kohë të pakufizuar.

Neni 5

Kostot financiare

Çdo kosto financiare që rezulton nga zbatimi i këtij memorandum i nënshtrohet legjislacionit në fuqi dhe është brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 6
Ndryshimet e memorandumit

Ndryshimet e këtij Memorandumi bëhen me shkrim, me miratimin e të dyjave Palëve.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe përfundimi i Memorandumit

1. Palët zotohen që të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi përmes konsultimeve miqësore e në mirëbesim mes Palëve.
2. Secila Palë mund të tërhiqet nga ky Memorandum në çdo kohë, përmes njoftimit me shkrim Palës tjetër.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dy Palëve.
2. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, ku 1 (një) kopje depozitohet pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 1 (një) kopje depozitohet pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”.

Nënshkruar në Shkodër më 04.04.2024, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

**PËR ZYRËN E INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË**



ARTUR METANI
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**PËR FAKULTETIN
E DREJTËSISË**



Dr. GASPER KOKAJ
DEKAN